



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, numër 12/2019), nenit 40 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar për lëndën e formuar pas denoncimit nga parashtruesi i panjohur dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

VENDIM

NDËRPRITET procedura për lëndën me numër 12-2987/1 me datë 06.06.2019 e formuar pas denoncimit nga parashtruesi i panjohur deri tek KSHPK.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-4819 nga viti 2019.

Lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-2987/1 me datë 06.06.2019 e formuar në bazë të denoncimit të fituar nga parashtruesi i panjohur.

Në denoncim flitet për akuza për numër të madh të dyshimeve për kryrje të veprimeve joligjore nga ana e UD Drejtori i, gjatë kohër kur ka qenë ndihmës-drejtor për trajnim dhe zhvillim të shkollës së mesme të përmendur. Në denoncim theksohet se para se të mer funksionin e UD Drejtori ai ka qenë në vendin e ndihmës-drejtorit për trajnime dhe zhvillim për rreth 10 muaj. Në këtë pozicion të punës në kohër kur nuk ka pasur kualifikim adekuat (ka pasur shkollim të lartë me 180 kredi) është regjistruar në studime të magjistraturës në fakultetin e makinerisë që të fiton titull më të lartë nëpërmjet rrugës së çrregullt. Njëkohësisht është paraqitur për provim që të fiton licencën për drejtor, edhe pse në atë kohë nuk ka pasur arsim adekuat. Nga llogaria e shkollës është bë pagesa e shumës për provim të drejtorit drejtpërdrejt në llogari të Qendrë shtetërore për provime pranë Ministrisë së arsimit dhe shkencës, gjë që është në kundërshtim me ligjin. Ai si ndihmës-drejtor ka shfrytëzuar automobil zyrtar për 10 muaj (24 orë brenda ditës) pa vendim të këshillit të shkollës. Gjithashtu në denoncim thuhet se ky person si ndihmës drejtor ka bërë shpenzime të mëdha për reprezentim (harxhime të mëdha në restorante në llogari të shkollës).

Me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike dhe kontrollimi të akuzave të denoncimit, KSHPK dorëzoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve me numër 12-238/1 me datë 15.01.2020 deri tek Qyteti i Shkupit – Njësia për revizion të brendshëm me të cilën kërkon që në kuadër të kompetenacve të tyre ligjore t'i kontrollon akuzat në denoncim dhe për përfundimin nga veprimi ta informon Komisionin shtetëror, përgjigjja e kërkuar është dorëzuar mbrenda afatit të caktuar me ligj në të cilën informojnë se Kryetari i Qytetit të Shkupit e ka informuar të qyteti të Shkupit për akuzat në denoncim dhe ka kërkuar urgjentisht të shprehen (deklarohen) për gjendjen faktike. Në përgjigjen e dorëzuar nga Qyteti i Shkupit theksohet se personi është i punësuar si profesor në shkollën e sipërpërmendur nga viti 1993 dhe i njëjti ka diplomë për përfundim të ciklit të dytë të studimeve në Fakultetin e makinerisë në Shkup. Për të theksuarën se ka vepruar që shkolla të bënë pagesën për provimin për drejtor është dorëzuar kopje nga kërkesa nga ana e personit dhe Vendim të Këshillit të shkollës për aprovim të pagesës prej 18.500,00 denarë për trajnim dhe provim për drejtor, miratuar në bazë të Vendimit për miratim të mjetve financiare për trajnime i zhvillim profesional të të punësuarve në shkollë. Për shfrytëzimin e automobilit zyrtar është dorëzuar autorizim nga ana e drejtorit të atëhershëm dhe Vendim për shfrytëzim të automobilit zyrtar nga ana e Këshillit të shkollës në QSHA.

Në deklarimin e dorëzuar nga shkolla deri tek KSHPK mohoen të gjitha akuzat e shënuara në denoncim, ndër të cilat është theksuar se personi është i punësuar pa ndërprerje në këtë shkollë prej 14.03.1993 dhe i njëjti ka Diplomë për përfundim të ciklit të dytë të studimeve në Fakultetin e makinerisë – Shkup, si magjistër për shkenca teknike nga fusha e sigurisë gjatë punës.

Nga shqyrtimi në rregullativën ligjore pozitive nga kjo fushë KSHPK konstatoi se:

Në përputhje me nenin 91 paragrafi 9 nga Ligji për arim të mesëm (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2008, 92/2009, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/2018) shpenzimet për përgaditje të kandidatëve për provim për drejtorit dhe shpenzimet për provim për drejtorit janë në llogari të kandidati i cili është i obliguar t'i paguan në llogari adekuate në Qendrën shtetërore për provime.

Në nenin 5 paragrafi 2 nga Ligji për trajnim dhe provim për drejtor në shkollat fillore, shkollat e mesme, konvikti për nxënës dhe Universiteti i hapur për qytetar për mësim tërë jetën (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 10/2015, 145/2015, 192/2016, 30/2016, 120/2018 dhe 140/2018) janë të shënuara kushtet dhe procedura për realizim të trajnimiti bazë dhe atë: kandidatët për drejtori të shkollave të mesme fitojn të drejtën e trajnimiti bazë nëse kanë së paku shkollim të lartë, i plotësojnë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunorë profesional në shkollë të mesme dhe kanë së paku 5 vjetë përvojë pune në procesin edukativo-arsimorë.

Kurse në nenin 7 janë të shënuara kushtet për paraqitje të kandidatëve për trajnim, e cila bëhet me shkrim me parashtrim të fletëparaqitjes, me fletëparaqitjen kandidati duhet t'i bashkangjitet:

1. Diplomë për arsim adekuat të lartë.

2. Vërtetim për përvojë pune në institucion edukativo-arsimor verifikuar nga ana e Ministrisë, lëshuar nga institucioni kompetent
3. Biografi e shkurët (rezyme, CV)
4. Kopje nga fletpagesa për pagesë të trajnimit

Nga shqyrtimi i bërë në dokumentacionin e arritur – përgjigje nga Qyteti i Shkupit është konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për elemente për dyshime në veprime joligjore të ndërmarra siç është theksuar në denoncim, por qartë shihet ka një varg të dobësive të konstatuara gjatë menaxhimit me shkollës.

Me qëllim të kontrollimit të punës së udhëheqësisë së kësaj shkolle është dorëzuar kërkesë deri tek Inspektoati shtetëror i arsimit me numër 12-2987/2 me datë 29.07.2020 me të cilën kërkohet që në kuadër të kompetencave të tyre të bëjnë inspektim të jashtëzakonshëm mbi ligjësinë e procedurës për provimin për drejtor nga ana e kandidatit / personit, procedura për emërim për UD Drejtor në të personit, a është vallë procedura e zhvilluar për zgjedhje të drejtorit nëpërmjet shpalljes publike në afatin e paraparë ligjor, ligjësia e vendimeve të Këshillit të shkollës për miratim të mjeteve finansiare të për trajnim dhe provimit për drejtor, si dhe ligjësia e vendimit për shfrytëzim të automobilit zyrtar të nga ana e

Nga Inspektorati shtetëror i arsimit është vepruar për kërkesën e KSHPK dhe me datë 23.09.2020 është bërë mbikqyrje e jashtëzakonshme inspektive me çka është konstatuar se në asnjë akuzë nga pikat e përmendura nga KSHPK të akuzave për dyshime për veprime joligjore të ndërmarra nga ana e UD Drejtor të atëhershëm, më vonë i zgjedhur dhe i emëruar si Drejtor në nuk ka dëshmi për vprime joligjore të kryera dhe procedura.

Me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike në mënyrë shtesë është kërkuar nga Drejtori i që dorëzon kopje nag Rregullorja për shfrytëzim të automobilit zyrtar të cilat i posedon, raport për shfrytëzim të automobilit zyrtar nga ana e personit gjatë kohës derisa ka qenë ndihmës-drejtor për trajnime dhe zhvillim në shkollën e mesme të përmendur, me dëshmi në shtojcë, dhe kopje nga akti për shfrytëzim të mjeteve finansiare në dedikuara për reprezentime të kësaj shkolle dhe Raport nga shfrytëzimi i mjeteve finansiare për reprezentim nga ana e personit gjatë kohës deris ka qenë ndihmës-drejtor për trajnime dhe zhvillim në shkollën e mesme të përmendur, me dëshmi në shtojcë.

Në afatin e caktuar me ligj janë dorëzuar dokumentacionet e kërkuara.

Nga shqyrtimi në dokumetacionin plotësues është konstatuar kjo:

- Personi, i punësuar si professr për mësim praktik në këtë shkollë në përputhje me nenin 92 nag Ligji për arsim të mesëm dhe me Vendim për shpërndarje me datë 13.07.2019 miratuar nga drejtori i atëhershëm i kësaj shkolle, është i caktuar për kryerje të detyrave të punës si ndihmës-drejtor për hulumtime, trajnime dhe zhvillim.
- Me datë 18.07.2019, i është dhënë Autorizim për shfrytëzim të automobilit zyrtar në teritorin e Republikës së Maqedonisë kurse ma datë 26.09.2018 edhe autorizim për shfrytëzim të automobilit të njëjtë edhe jashta kufijve të Republikës së Maqedonisë.

- Personi si ndihmës drejtor në periudhën prej 13.07.2018 deri më 06.06.2019 për shfrytëzim të automobilit zyrtar ka ngritur pikë për karburant në vlerë prej 31.000,00 denarë. Në shtojcë janë dorëzuar dhe urdhëresat e rrugës dhe kasa-pranimi për ngritje mjeteve nga arkatari.
- Personi si ndihmës drejtor në periudhën prej 13.07.2018 deri më 06.06.2019 për shfrytëzim të mjeteve financiare për reprezentime ka të harxhuara 100.660,00 denarë. Në shtojcë vërtetim-llogarie dhe fatura për harxhimin e mjeteve nga të cilat pjesa më e madhe janë harxhuar në organizimin e festimeve para viti të ri për të gjithë të punësuarit në Në informimin e dorëzuar deri tek shërbimi për kontabilitet dhe finansa janë të nënshkruar edhe drejtori i atëhershëm edhe ndihmës-drejtori i përmendur.

Duke pasë parasyshë Procesverbalin nga inspektimi i jashtëzakonshëm i bërë numër 09-580 me datë 28.09.2020 i përpiluar nga inspektori nga Inspektorati shtetëror iarsimit i cili ka konstatuar se Inspektorati me datë 23.09.2020 ka bërë inspektim të jashtëzakonshëm me çka është konstatuar se asnjë pikë nga të kërkuara nga KSHPK për akuzat për vperime joligjore nga ana e UD Drejtor Goranço Nikolovski i cili tashmë është i zgjedhur dhe i emëruar për Drejtor në nuk ka veprime të kryera joligjore dhe procedura. Me qëllim të shqyrtimit të veprimit të inspektorit në rastin konkret, KSHPK deri tek Këshilli i inspektimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dorëzoi kërkesë për veprim kompetent me të cilën në përputhje me nenin 18 paragrafi 1 pika 1 dhe 19 me të cilën kërkon që Këshilli ta rishqyrton punën e inspektorit në rastin e sipërpërmendur dhe për rezultate ta informon Komisionin shtetëror.

Në përgjijen e dorëzuar, Këshilli i inspektimit informoi se në seancën e rregullt të 196-të të mbajtur me datë 14.02.2021, e ka rishikuar Kërkesën e KSHPK për rishqyrtim të punës së inspektorit shtetëror i cili me kërkesë të Komisionin shtetëror për parandalim të korrupsionit ka bërë inspektim në punën e gjatë së cilës përpiloi Procesverbal IP1 nr. 09-580 me datë 28.09.2020 në të cilën është konstatuar se nuk janë vërtetuar akuzat e Komisionit shtetëror. Nga analiza gjithëpërfshirëse e akteve që burojnë nga veprimi për lëndën konkrete, Këshilli inspektimit veproi për kërkesën për rishqyrtim të punës së inspektorit shtetëror të arsimit në lidhje me realizimin e inspektimit të jashtëzakonshëm mbi punën e, inicuar nga ana e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe gjatë asaj nuk vërtetoi parregullsi në procedurën e zbatuar nga inspektorit shtetëror të arsimit.

Duke pasë parasyshë të gjithë të konstatuarën më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit konstaton se në rastin konkret ka vepruar organ kompetent (inspektorati shtetëror i arsimit) i cili në kuadër të kompetencave të veta ligjore, ka vepruar në rastin konkret, e ka caktuar gjendjen faktike me çka nuk janë konstatuar dëshmi për ekzistimin e elementeve për dyshime për veprime të kryera joligjore të Drejtorit të të përmendur, gjatë kohës kur ka qenë ndihmës-drejtor prr trajnim dhe zhvillim në shkollën e mesme të përmendur, por janë vërejtur vetëm dobësi gjatë menaxhimit me shkollën. Duke pasë parasyshë të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror përfundon se akuzat në denoncim nuk janë vërtetuar dhe prej këtu përfundon se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent për rastin konkret dhe i njëjti të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasysh të theksuarën më sipër, Komision shtetëror për parandalim të korrupsionit, vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Pas përfundimit të KSHPK

Përpunoi: m-r I. P.

Miratoi: N. B., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Zëvendës-Kryetarë: m-r Shemshi Sallai**

